



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 5

2002

Mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8858 datë 14.2.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999; nr. 8519, datë 30.7.1999; nr. 8552, datë 18.11.1999; nr. 8581, datë 17.2.2000; nr. 8651, datë 28.6.2000 nr. 8713, datë 15.12.2000 dhe nr. 8840, datë 11.12.2001.....	103
Dekret nr. 3261 datë 27.2.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	104
Vendim i GJ.K nr. 24, datë 13.2.2002	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 85, datë 29.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	105
Vendim i GJ.K nr. 25, datë 13.2.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues i pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".....	107
Vendim i Gj.K nr. 28, datë 21.2.2002	Interpretimi i neneve 96 e 97 të kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe pezullimi i procedurave të shqyrtimit për miratim të Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij.....	109

Udhëzim i KQZ nr.1, datë 12.1.2002	Për emërimin e anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit kur nuk arrihet kuorumi i nevojshëm për zgjedhjet për këshillin e komunës Kolsh të qarkut të Lezhës	110
Udhëzim i KQZ nr. 2, datë 7.2.2002	Për hapjen e kutive të votimit dhe administrimin e dokumentacionit të saj	111
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për vënien në kujdestari ndaj shtetasit Vasil Zenkollari	112
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Hasan Bregu	112

LIGJ
Nr. 8858, datë 14.2.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8435, DATË 28.12.1998 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR. 8508, DATË 7.7.1999; NR. 8519, DATË 30.7.1999; NR.8552, DATË 18.11.1999; NR. 8581, DATË 17.2.2000; NR. 8651, DATË 28.6.2000 NR. 8713, DATË 15.12.2000 DHE NR. 8840, DATË 11.12.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Arben Malaj,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999; nr. 8519, datë 30.7.1999; nr. 8552, datë 18.11.1999; nr.8581, datë 17.2.2000; nr. 8651, datë 28.6.2000 nr. 8713, datë 15.12.2000 dhe nr. 8840, datë 11.12.2001 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 22 e nenit 2 shfuqizohet.
2. Shkronja "r" e nenit 6 shfuqizohet.
3. Shkronja "o" e pjesës "A." "Për taksat kombëtare" të nenit 9 shfuqizohet.
4. Paragrafët me numër 14 dhe 5 të nenit 10 shfuqizohen.
5. Lidhja nr.10 "Taksa mujore e solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen" shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik 2002.

Shpallur me dekretin nr.3260, datë 27.2.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

DEKRET
Nr. 3261, datë 27.2.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Emanuela Xhemal Murawski (Elezi)
2. Alban Ylvi Binozi

3. Ruzhdi Dari Saliu
4. Aldo Ruzhdi Saliu
5. Erjola Ruzhdi Saliu
6. Engjëllushe Murat Saliu (Cemani)
7. Fatjon Ruzhdi Saliu
8. Zef Luigj Frani
9. Enida Zef Frani
10. Liza Ndue Frani (Zefaj)
11. Aldo Zef Frani
12. Alma Veiz Matzen (Zenka)
13. Ylli Nebi Nuredikaj
14. Franc Ylli Nuredikaj
15. Sara Ylli Nuredikaj
16. Pranvera Zenan Kamberaj (Merkohasani)
17. Kostandin Theodhor Jaçe
18. Elmira Hajdar Jaçe (Kryekurti)
19. Albi Kostandin Jaçe
20. Mimoza Kadri Mönkemeyer (Sadrija)
21. Mehdi Hajdar Kepi
22. Mario Hajdar Mehdi Kepi
23. Edlira Rustem Kepi (Beçerri)
24. Artan Minir Rapka
25. Shpëtim Tasin Shehu
26. Eni Shpëtim Shehu
27. Andi Shpëtim Shehu
28. Diana Petrit Shehu (Demetja)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

VENDIM
Nr. 24, datë 13.2.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	""
Gjergj Sauli	Anëtar i	""
Kujtim Puto	Anëtar i	""
Kristofor Peçi	Anëtar i	""
Tefta Zaka	Anëtare e	""
Petrit Piloçi	Anëtar i	""
Sokol Sadushi	Anëtar i	""
Alfred Karamuço	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 28.12.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.216/16 Akti që i përket:

Kërkues: Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, përfaqësuar nga avokat Haki Kraja.

Subjekte të Interesuara:

1. Trashëgimtarët e Kosta Koculit, në mungesë.

2. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, në mungesë.

Objekti: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.85, datë 29.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në kërkesë si shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm paraqiten:

Në shqyrtimin e çështjes dhe në marrjen e vendimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë zhvilluar një proces jo të rregullt në këto drejtime:

- Gjykata e Lartë me vendimin e saj ka marrë përsipër të zgjidhë papajtueshmërinë me dispozitat kryesore kushtetuese të dekretit të Presidentit nr.204 datë 5.6.1992, duke ndërhyrë në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese.

- Në vendim, Gjykata e Lartë ka marrë funksionet e organit ligjvënës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Mbi bazën e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 204, datë 5.6.1992, Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë i është njohur si pronë ndërtesa nr. 5 e ish-Kampit të Punëtorëve, Dhërmi.

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, me vendimin nr. 204, datë 14.11.1994, këtë objekt e ka njohur si pronë të trashëgimtarëve "Koculi" dhe ua ka kthyer atyre.

Konfederata e Sindikatave ka kërkuar gjyqësisht shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Komisionit, por padia e saj është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr. 226, datë 5.2.1996, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 3438, datë 14.6.1996. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.639, datë 29.4.1997, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

Mbi bazën e rekursit në interes të ligjit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet vendimit unifikues nr. 85, datë 29.6.2001, kanë lënë në fuqi vendimet e mësipërme.

1. Në vendimin e tyre Kolegjet e Bashkuara kanë vërejtur se dekreti i Presidentit nr.204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave" jo vetëm që nuk i është paraqitur për miratim Kuvendit në sesionin më të afërt, por edhe nuk është kundërfirmuar nga Kryeministri apo Ministri i Financave. Për rrjedhojë, konkludojnë Kolegjet, ky dekret nuk konsiderohet se ka marrë fuqi juridike.

Përmbajtja si më sipër e vendimit nuk e bën atë antikushtetues, sepse nuk është disponuar mbi kompetencat që ka Gjykata Kushtetuese. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ashtu si çdo hallkë gjyqësore, detyrohen t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për një dispozitë ligjore kur ata gjykojnë se ajo është antikushtetuese e duhet të shfuqizohet. Në rastin në shqyrtim, dekreti është inekzistent, sepse në bazë të ligjit nr.8340, datë 6.5.1998 ai nuk është miratuar nga Kuvendi, e për pasojë Gjykata Kushtetuese nuk mund të investohet për akte inekzistente. Rivlerësimi nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të faktit se dekreti nuk ka marrë fuqi juridike, është i drejtë dhe nuk e bën vendimin antikushtetues.

2. Nga shqyrtimi i vendimit nr. 85, datë 29.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk del që ajo të ketë marrë rolin e organit ligjvënës, ashtu siç parashtron kërkuesi.

Në vendim, duke analizuar ligjin nr. 8340/1, datë 6.5.1998 "Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr. 204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave", Gjykata e Lartë ka shprehur pikëpamjen e saj lidhur me fuqinë prapavepruese të tij, ashtu si duke shqyrtuar edhe ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", ka konkluduar lidhur me kolizionin midis këtyre dy ligjeve. Kolegjet shprehen se ligji nr. 8340/1, datë 6.5.1998 është i zbatueshëm për atë që nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993.

Edhe në këto konkluzione me karakter unifikues, Gjykata Kushtetuese nuk gjen shkaqe për t'i shpallur ato antikushtetuese. Interpretimi i ligjeve është para së gjithash e drejta për çdo organ që i zbaton ato. Aq më tepër që, në organet gjyqësore, interpretimi i ligjeve përbën pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së tyre, lidhur ngushtë me çështjet konkrete që shqyrtojnë. Edhe nëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit nuk është bërë drejt nga organet gjyqësore, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese për t'i korrigjuar ato. Gjykata Kushtetuese nëpërmjet kontrollit kushtetues ndërhyr kur konstaton se në gjykim janë shkelur principet themelore të procesit.

Në këto kushte, kërkesa duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 25, datë 13.2.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Petrit Ploçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 14.11.2001 dhe 21.12.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.174/4 Akti që i përket:

Kërkesë:Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skraparit.

Subjekte të interesuara:

1. Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Ilir Shurdhi, këshilltar juridik.

2. Presidenti i Republikës, në mungesë.

3. Prokurori i Përgjithshëm, zoti Arben Rakipi.

Objekti: Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Në kërkesë parashtrohen si shkaqe:

Dispozita e mësipërme vjen në kundërshtim me nenet 6, 7, 42/2, 44 e 49/1 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe me nenin 13 të Konventës Europiane "Për të drejtat e njeriut".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në zbatim të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Skrapar ka pezulluar çështjen civile që i përket Fatmir Lirzës dhe i ka parashtruar Gjykatës Kushtetuese nevojën e shfuqizimit si antikushtetuese të pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë...", e cila ka këtë përmbajtje: "Dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra është i paankimueshëm".

Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita e atakuar nuk është në përputhje me përmbajtjen dhe frymën e Kushtetutës dhe të dokumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Në arritjen e një konkluzioni të tillë Gjykata ka parasysh arsyet e parashtruara më poshtë:

Kushtetuta, mundësinë e individit për t'iu drejtuar gjykatave për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e atyre ligjore për shkak të rëndësisë së posaçme, e ka parashikuar shprehimisht si të drejtë themelore vetiake në nenin 42 të saj. E drejta e ankimit pranohet si e drejtë themelore edhe nga Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut (neni 13) dhe se ushtrimi i kësaj të drejte është i pakufizuar.

Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta, e si e tillë ajo duhet të konkretizohet me ligjin "Për Prokurorinë". Kufizimi që i bën kësaj të drejte dispozita e ligjit, lidhur me masat që merr ndaj tyre Presidenti i Republikës, nuk gjen mbështetje edhe tek neni 17 i Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kufizime mund të vendosen vetëm kur ka interes publik dhe kur mbrohen të drejtat e subjekteve të tjera. Në këtë dispozitë kushtetuese, veç sa më sipër, vihen si kushte që kufizimi të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar, të mos cenohet thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe të mos tejkalohet në asnjë rast kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke iu referuar në tërësi dispozitës së kontestuar nenit 34 të ligjit "Për Prokurorinë", është e nevojshme të theksohet se lidhur me të drejtën e ankimit ndaj masave disiplinore ajo përmban dy standarde. Ndërsa për masat "vërejtje me paralajmërim "e" pezullim nga detyra", të cilat merren nga Prokurori i Përgjithshëm, ligji parashikon ankim në gjykatën e apelit (pika 1 e nenit 34) për masën e shkarkimit nga detyra, e cila merret me dekret të Presidentit të Republikës, prokurorët nuk kanë të drejtën e ankimit.

Tek dispozita në shqyrtim dallohen tre karakteristika:

Së pari, e drejta kushtetuese e ankimit nuk mohohet tërësisht, por ajo për të njëjtin subjekt parcelizohet pa pasur asnjë bazë kushtetuese.

Së dyti, ligji përmban një parregullsi, duke pranuar ankimin për masat më të lehta e duke e mohuar për ato më të rënda.

Së treti dhe më e rëndësishmja, të drejtën e ankimit ligji e lidh me cilësitë e subjektit që merr masën.

Përsa i përket karakteristikës së fundit, Gjykata Kushtetuese e sheh të arsyeshme të ndalet shkurtimisht te natyra e akteve që nxjerr në këto raste Presidenti i Republikës.

Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del qartë se Presidenti i Republikës, si kryetar i shtetit, edhe pse është i ndarë nga organet kryesore që realizojnë pushtetet, kryen disa funksione që kanë natyrën e këtyre pushteteve. Është kjo arsyeja që Presidenti i Republikës, në ushtrimin e funksioneve të tij, krahas akteve që janë rezultat dhe shprehje e drejtimit politik, nxjerr akte individuale me karakter administrativ. Në aktet me karakter administrativ përfshihen edhe dekretet për shkarkimin nga detyra të prokurorëve si masë me karakter disiplinor. Duke pasur të tilla cilësi, dekreti, në bazë të dispozitave kushtetuese të përmendura më lart dhe në harmoni me frymën e përmbajtjen e legjislacionit e të praktikës së mirëfilltë gjyqësore, duhet të jetë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor.

Në argument të antikushtetutshmërisë së dispozitës së kontestuar mund të shërbente edhe dallimi që kanë prokurorët në raport me subjekte të tjerë. Kështu, edhe pse prokuroria organizohet e funksionon pranë sistemit gjyqësor, prokurorët nuk gëzojnë të drejtën e ankimit ndaj shkarkimit nga detyra, të drejtë që gjyqtarëve u njihet nga Kushtetuta (neni 147). Prokurorët dallojnë edhe nga nëpunësit e tjerë civilë përse i përket të drejtës së ankimit. Dallimet si më sipër cenojnë frymën e përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Me shfuqizimin e pikës 2 të nenit 34 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", krijohet një boshllëk ligjor e, për pasojë, lind nevoja e plotësimit të dispozitës së mësipërme nga organi ligjvënës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" me këtë përmbajtje: "Dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra është i paankimueshëm".

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 28, datë 21.2.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21.2.2002, në seancë plenare, mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, mori në shqyrtim çështjen nr.46 Akti që i përket:

Kërkues: Një grup prej 29 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë.

Subjekt i interesuar:

1. Kuvendi i Shqipërisë
2. Këshilli i Ministrave

Objekti: Interpretimi i neneve 96 e 97 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe pezullimi i procedurave të shqyrtimit për miratim të Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij.

Baza ligjore: Nenet 134/1-c dhe 124/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Një grup prej jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë kanë paraqitur për shqyrtim kërkesën me objekt: "Interpretimi i neneve 96 e 97 të Kushtetutës, si dhe pezullimi i procedurave të shqyrtimit për miratimin e Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi çështjen mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, në bazë të neneve 124, 132 e 143/1- c të Kushtetutës, si dhe neneve 45, 71, 72 e 79 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Interpretimin e neneve 96 e 97 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në këtë mënyrë:

- Kryeministri i emëruar nga Presidenti i Republikës miratohet në Kuvend njëherësh me programin politik dhe me përbërjen e Këshillit të Ministrave.

- Hiqet masa e pezullimit të procedurave të shqyrtimit për miratim nga Kuvendi të Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij, e vendosur me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese datë 20.2.2002.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

UDHËZIM

Nr. 1, datë 12.1.2002

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT KUR NUK ARRIHET KUORUMI I NEVOJSHËM PËR ZGJEDHJET PËR KESHILLIN E KOMUNËS KOLSH TË QARKUT TË LEZHËS

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Enkeleda Dollaj, në mbledhjen e tij të datës 12.1.2002, me pjesëmarrjen e :

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

U D H Ë Z O N:

1. Nëse deri në datën e zgjedhjeve Komisioni Zgjedhor i Qeverisjes Vendore të Komunës Kolsh nuk arrin të ngrejë qendrat e votimit sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 të Kodit Zgjedhor apo nëse nuk arrin të krijojë kuorumin e nevojshëm për realizimin e procesit të vendimmarrjes dhe organizimit e mbarëvajtjes së zgjedhjeve në qendrën e votimit, atëherë në datën e zgjedhjeve Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron menjëherë anëtarët e nevojshëm për plotësimin e kuorunit.

2. Plotësimi i kuorunit për anëtarët e komisionit të qendrave të votimit të bëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me propozim të partive që kanë marrë më shumë vota pas shtatë partive të para për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të vitit 2001, e përkatësisht:

- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut,
- Partia Lidhja Fshatare Shqiptare.

3. Nëse përsëri nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm për realizimin e procesit të zgjedhjeve në qendrën e votimit, atëherë plotësimi i kuorunit të bëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me propozim të partive politike që kanë marrë vota në zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, të cilat nuk kanë përfaqësues në qendrën e votimit dhe përkatësisht:

- Partia Demokrate,
 - Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar,
 - Partia e Komunistëve të Bashkuar,
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

UDHËZIM

Nr. 2, datë 7.2.2002

PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT DHE ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT TË SAJ

Në mbështetje të neneve 18 pika 1, 106 pika 8 dhe 149 pika 5 e 6 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N:

1. Me marrjen e kutive të votimit dhe fletëve të votimit të papërdorura dhe pas përfundimit të afatit për ankimet, sipas pikës 5 të nenit 113 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve hap të gjitha kutitë e votimit.

2. Për organizimin dhe kontrollin e punës për hapjen dhe selektimin e materialeve që do të ruhen dhe asgjësohen, ngrihet një komision i cili përbëhet nga:

- | | |
|--|---------|
| - Sekretari i Komisionit Qendror | Kryetar |
| - Drejtori i Drejtorise së Logjistikës | Anëtar |
| - Drejtori i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore | Anëtar |
| - Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve | Anëtar |
| - Përgjegjësi i Zyrës së Protokoll – Arkivit | Anëtar |

3. Hapja e kutive të votimit do të kryhet nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore, e cila në këtë proces do të aktivizojë specialistët e kësaj Drejtorie, si dhe një deri në dy inspektorë të Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore në varësi të volumit të punës, afatit të caktuar për përfundimin e procesit, si dhe të fondeve në dispozicion. Për plotësimin e kësaj detyre, Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore krijon disa grupe pune me këtë përbërje:

- një specialist,
- dy punëtor.

Hapja e kutive të votimit do të bëhet veças për çdo zonë zgjedhore.

4. Grupi i punës, me procesverbal, hap çdo kuti votimi, grupon veças dokumentet që do të arkivohen, materialet që mund të ripërdoren dhe pjesën tjetër që përbën materialet që do të asgjësohen. Ky procesverbal nënshkruhet çdo ditë edhe nga drejtori i Drejtorisë së Logjistikës Zgjedhore.

5. Dokumentacioni i cili do të dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit dhe do të ruhet për një afat kohor prej 5 vjetësh, është:

- procesverbalet e votimit,
- tabelat e rezultateve dhe procesverbalet e numrit të fletëve të votimit.

Sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, harton një grafik në lidhje me dorëzimin e materialeve që do të ruhen.

6. Materialet të cilat mund të përdoren edhe në zgjedhjet e tjera, magazinohen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Të gjitha materialet e tjera që gjenden në kutitë e votimit, të cilat nuk përfshihen në dokumentacionin e përmendur në pikat 5 e 6 të këtij vendimi, të ambalazhohen në thasë plasmasi dhe të bëhet asgjësimi i tyre nëpërmjet djegies.

8. Asgjësimi i dokumentacionit të panevojshëm, që gjendet në kutitë e votimit, do të bëhet me procesverbal, në prezencë të Komisionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

VENDIM **(I SHKURTUAR)**

Me vendim nr.203, datë 5.2.2002, Gjykata e Rrethit Korçës vendosi vënien në kujdestari të përkohshme të Robert Zenkollarit, ndaj shtetasit Vasil Zenkollari.

VENDIM **(I SHKURTUAR)**

Me vendim nr.55, datë 6.2.2002, Gjykata e Rrethit të Skraparit ka vendosur të shpallë të zhdukur shtetasin Hasan Bregu dhe kujdestare për administrimin e pasurisë së tij të caktohet Merzai Bregasi.

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren nr.5, të vitit 2001 ligji nr.8737, datë 12.2.2001, neni 8 pika 1 (Detyrat) rreshti i dytë,

është: si dhe për parandalimin

duhet: si dhe për përmbushjen

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 6.3.2002
Doli nga shtypi më 7.3.2002

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë